

**AKT THEMELIMI I
SHOQËRISË TREGTARE
“DELUXE CONSTRUCTION” SH.P.K
ME SELI NË TIRANË**

Sot, më datë 10.01.2022 (dymijëenjzetedy):

- **Z. Dritan MARKU**, shtetase shqiptare, i datëlindjes 10.04.1978, lindur në Mat dhe baues në Tiranë, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër peronal H80410274J.
- **Z. Sotis PAPULI**, shtetase shqiptare, i datëlindjes 31.05.1996, lindur në Tiranë dhe baues në Tiranë, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër peronal J60531045A.

Vendosi:

Themelimin e shoqërisë tregtare “**DELUXE CONSTRUCTION**” SH.P.K, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqërinë Tregtare “**DELUXE CONSTRUCTION**” SH.P.K, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (në vazhdim Shoqëria). Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

NENI 2

Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “**DELUXE CONSTRUCTION**” SH.P.K

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë kryerja e çdo aktiviteti tregtar të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrja në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar në baze të legjislacionit shqiptar, siç mund të ndryshohet here pas here dhe në veçanti, por pa u kufizuar në;

- *Shoqëria do të ushtroje aktivitet privat në fushën e ndertimit privat dhe publik. Germime dheu. Ndertime civile, industriale etj. Rikonstruksione. Import - Eksport, me shumice dhe pakice të artikujve të ndryshëm. Import - eksport me*



shumice e pakice te lendeve te para, materialeve te ndertimit, pajisjeve, makineri etj. Tregtim me shumice e pakice i materialeve te ndertimit te te gjitha llojeve ne funksion te ndertimit e rikonstruksionit te objekteve civile industriale dhe transportimi i tyre. Të kryejë çdo biznes, punë ose veprimtari që lidhet me çdo lloj pasurie të luajtshme ose të paluajtshme në përgjithësi.

Gjithashtu, shoqëria mund te kryeje çdo aktivitet tjetër qe lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektivin e mësipërm, çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, si dhe çdo veprimtari me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme që mund te konsiderohet i nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të shoqërisë.

Për ushtrim të aktivitetit të shoqërisë me gjithë ndryshimet që mund të ketë shoqëria mund të hyjë më marrëveshje partneriteti dhe bashkëpunimi me palë të tretë qofshin ente publike apo private, të marrë pjesë në procedura të ndryshme konkurrimi në përputhje me legjislacionin ne fuqi. Të gjitha veprimtaritë do të zhvillohen në përputhje me ligjin që rregullon ushtrimin e asaj veprimtarie. Shoqëria do të marrë të gjitha licencat dhe miratimet që mund të jenë të nevojshme për zhvillimin e veprimtarive të sipërpërmendura sipas kërkesave të ligjit të fushës.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, Njësia Administrative Farkë, Fshati Mullet, "Long Hill Residence", ZK.2735, Godina Nr.1, Pasuria Nr. 53/51, Petrelë, Tiranë.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në vlerën prej 100,000 (njëqindmijë) lek.

Ortakët themelues të Shoqërisë zotërojnë kuotat si më poshtë:

- 1. Dritan MARKU** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 66.7 % të vlerës së kapitalit themeltar të Shoqërisë të barabartë me 1 kuotë me vlerë nominale 66,700 (gjashtëdhjetëegjashtëmijëeshtatëqind) lek.
- 2. Sotis PAPULI** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 33.3% të vlerës së kapitalit themeltar të Shoqërisë të barabartë me 1 kuotë me vlerë nominale 33,300 (tridhjetremijëetreqind) lek.

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët themelues në rast të miratimit të kësaj kontrate themelimi dhe të firmosur nga ta.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktiviteti fillon pas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët zgjidhen për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

- *Administratori i Shoqërisë do të jetë Z. Dritan MARKU, shtetas shqiptar, i datëlindjes 10.04.1978, lindur në Mat dhe baues në Tiranë, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër personal H80410274J.*

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi

NENI 8

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 9

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të

zhëdmojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët/u themelues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 12

Dispozitat përfundimtare

Akti i Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe është në përputhje me vullnetin e lirë të themeluesit, i cili, nëpërmjet përfaqësuesve të tij e nënshkruan pa vërejtje.

ORTAKËT THEMELUES

Dritan MARKU

Sotis PAPULI

Dritan Marku

Sotis Papuli



Tiranë, më datë 12.01.2022

AUTORIZIM

Shoqëria “**DELUXE CONSTRUCTION**” SH.P.K e përfaqësuar nga Administratori Z.Dritan MARKU, mbajtës i kartës së identitetit me numër peronal H80410274J, autorizon z. Ilir ZYLFO të cilit i jep të drejta dhe kompetenca të plota për të përfaqësuar Shoqërinë “**DELUXE CONSTRUCTION**” SH.P.K në procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Të gjitha veprimet e kryera prej të Autorizuarit unë i konsideroj të drejta dhe të mirëqena sikur të ishin kryer vetë prej meje.

Ky autorizim është i vlefshëm deri në përmbushjen e qëllimit për të cilin është lëshuar.

AUTORIZUES

ADMINISTRATORI
“DELUXE CONSTRUCTION” SH.P.K

Z. Dritan MARKU

Dritan Marku

